



Prishtinë, 10.07.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3288_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2963_04_25** i datës 27.04.2026;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 26.05.2026.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **B. M.**, nga Komuna e Deçanit, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2963_04_26 i datës 27.04.2026.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 27.04.2026 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2963_04_26 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit B. M., me shifër DPE – 125962, lidhur me kontestimin e faturës së muajin 08/2025, nën dyshimet për pasaktësi të matjes me njehsorin elektrik me nr. 86021885.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Faturimi i kontestuar nuk përputhet me konsumin real dhe ekzistojnë dallime të mëdha krahasuar me periudhat e mëparshme;
- Konsumatori kërkon rishqyrtimin e vendimit të kontestuar, si dhe verifikimin e saktë të njehsorit dhe leximeve si dhe analizimin e faturimit të kontestuar dhe korrigjimin financiar, nëse konstatohet faturim i pasaktë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e konsumatorit të dt. 26.05.2026; Vendimin e DMK-së të dt. 27.04.2026, Ankesën e konsumatorit në DMK e dt. 25.09.2025, Përgjigjen e KESCO-s, Transaksionet e konsumatorit, Listat e leximit dhe Rrjedhën e energjisë elektrike, Procesverbalin e inspektimit të dt. 08.08.2023 me nr. 2110957, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Bordi i ka analizuar me kujdes edhe Listat e Leximit, Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Transaksionet dhe ka gjetur se, kjo pikë matëse është lexuar dhe është faturuar me rregull, dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi. Nga analizimi i mëtejshëm i Listave të Leximit, vihet re që, konsumatorit i është ndërruar njehsori elektrik në muajin 07/2025, dhe nga matja është larguar njehsori elektrik me nr. 17692913 i llojit Mekanik, dhe për matje është vendosur një njehsori i ri, me nr. 86021855 i llojit PLC. Bordi ka gjetur se, deri në momentin e ndërrimit të njehsorit elektrik të konsumatorit, për periudha të caktuara, në lista të leximit janë evidentuar disa parregullsi në pikën matëse të konsumatorit, si “metter inside” ose njehsori brenda, dhe se konsumatori, për periudha të caktuara kohore, ishte faturuar vetëm me taksë fikse, pa lexim të rregullt të shpenzimeve të tij ose me vlerësim/pa faturim. Në këtë kuptim, mos qasja e punëtorëve të autorizuar të OSSH-së në pikën matëse është në kundërshtim me nenin 25 – Qasja në Pronë të Konsumatorit, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si në vijim: *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji. 2. Nëse konsumatori nuk lejon qasje për leximin e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet bazuar në mesataren e faturave gjatë tre (3) muajve të mëparshëm. 3. Refuzimi i paarsyeshëm dhe i vazhdueshëm i konsumatorit që t’i lejojë qasje në pronë ndërmarrjes së energjisë, mund të pasoj shkyçja sipas dispozitave të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë”,* ashtu që, konsumatori ka vepruar në kundërshtim me këtë obligim ligjor.

Gjithsesi, duhet theksuar se, pas ndërrimit të njehsorit elektrik, pra vendosjes së njehsorit me nr. 86021885 ka lexim nga distanca, ose AMR, dhe nuk është evidentuar ndonjë parregullsi në pikën matëse të konsumatorit, pas kësaj periudhe. Në këtë kuptim, faturën të cilën konsumatori e konteston, gjendja e shpenzimeve është në TL = 1443.21 kWh dhe TU = 893.09 kWh apo në total shpenzimi prej 2336.3 kWh apo shprehur në vlerë financiare prej 267.94 €. DMK thekson se, shpenzime të përafërta, konsumatori ka pasur edhe një muaj më parë, pra në muajin 07/2025, me total të shpenzimeve prej 1787.09 kWh apo shprehur në vlerë financiare prej 196.72 €.

Bordi e ka analizuar me kujdes edhe Procesverbalin e Kontrollimit – Pranimi të Grupit Matës të KEDS, me nr. 018995, i dt. 16.09.2025, për konsumatorin me shifër DPE – 125962, në të cilin ndër të tjera është evidentuar se: *“Me kërkesë të konsumatorit, është shqyrtuar njehsori elektrik me instrument ZERA, që tregon se vlerat rezultojnë të jenë brenda kufijve të lejuar të matjes. Njehsori elektrik pllombohet”*. Testimi momental i njehsorit me ZERA ka rezultuar 0.03%, 0.05% dhe 0.09%. Sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Kodin e Matjes së OSSH-së, rezulton që njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes, në të cilin është përcaktuar vlera e lejuar e gabimit prej +/-2.5 %.



Nga sa mund të shihet, Furnizuesi KESCO ka vepruar në harmoni me nenin 28 – Faturimi të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ashtu që, *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”*.

Rrjedhimisht, konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të cilën e shfrytëzojnë dhe kjo duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me energji elektrike, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si vijon: “Konsumatorët e kanë për obligim që paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast. Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Faturave të kontestuara, të dhënave të pranuar nga KESCO si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji si dhe Rregullën për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar



Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **B. M.**
- Arkivit të ZRrE-së